1288
196/1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 6764/2 prot. Tiranë, më 25.10.2018

Lënda: Kthim përgjigje kërkesës suaj nr.196/18 prot., datë 11.10.2018

QENDRËS "RES PUBLIKA"
Blv "Gjergj Fishta" Nd. 24, H.3, Ap.44, Kati 9
TIRANË

z. DORIAN MATLIJA
DREJTOR EKZEKUTIV

I nderuar z. Matlija,

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, ju vë në dijeni se u njoh me kërkesën tuaj nr.196/18 prot., protokolluar me tonën nr. 6764 prot., datë 11.10.2018.

Në lidhje me sa kërkoni në shkresën tuaj, ju informojmë si më poshtë:

Sa i përket pikës së parë, sqarojmë se në nenin 4, të ligjit nr. 84/2016 „Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", parashikohen tri kritere për rivlerësimin e subjekteve: kriteri i pasurisë, kriteri i pastërtisë së figurës dhe vlerësimi profesional, ndërsa në nenin 61 të këtij ligji parashikohen rastet e dhënies së masës së shkarkimit nga detyra, me vendim të Komisionit.

Në lidhje me pikën e dytë të kërkesës suaj, ju informojmë se Komisioni ka referuar një rast kryesisht dhe një rast tjetër me kërkesën e vetë prokurorisë.

Gjithashtu sjellim në vëmendje se, në faqen zyrtare të Komisionit, *kpk.al*, mund të gjenden informacione të tjera të dobishme për akses nga publiku.

Duke ju falënderuar,

KRYETARI
Genta Tafa (Bungo)